



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:255361

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05874664

C.nr.2371/2023

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtari Berat Spahiu, në çështjen kontestimore të paditëses T.I nga ..., Republika e Serbisë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av. Gazmend Zymeri nga Gjilani, kundër të paditurit S.A nga fshati ..., K. e Gjilanit, për besimin e fëmijës së mitur në ruajtje, kujdes dhe edukim dhe rregullimin e kontakteve personale, pas mbajtjes së seancës gjyqësore jopublike të datës 28.06.2024, bie këtë:

A K T V E N D I M

I. Konsiderohet e tërhequr padia e paditëses T.I nga Presheva, e ushtruar ndaj të paditurit S.A nga fshati ..., K. e Gjilanit, për besimin e fëmijës në ruajtje, kujdes dhe edukim dhe rregullimin e kontakteve personale.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësja T.I, në këtë gjykatë, më datë 22.11.2023, ka ushtruar padi ndaj të paditurit S.A me objekt kontesti besimi i fëmijës së mitur në ruajtje, kujdes dhe edukim dhe rregullimi i kontakteve personale.

Lidhur me këtë çështje, gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor për datë 28.06.2024, me fillim në orën 13:30, në të cilën seancë ka munguar pa arsye /ose së paku nuk ka prova se mungesa e palëve është e arsyetuar/ përfaqësuesi i paditëses, av. Gazmend Zymeri, i cili ka qenë i njoftuar në mënyrë të rregullt për këtë seancë përmes procesverbalit të seancës së datës 13.06.2024, ndërsa mungesën në seancë nuk e ka arsyetuar.

I padituri S.Ai ka propozuar gjykatës që padia e paditëses të konsiderohet e tërhequr.

Andaj, konform nenit 423.3 të LPK-së /Ligji nr. 03/ L-006, 30 qershor 2008/, ku shprehimisht është përcaktuar se “Në qoftë se paditësi nuk vjen në seancën kryesore, edhe pse është thirrur rregullisht, konsiderohet se e ka tërhequr padinë, përveçse kur i padituri deklaron se kërkon që

të zhvillohet shqyrtimi kryesor i çështjes në mungesë të paditësit”, gjykata e ka konsideruar të tërhequr padinë e paditëses.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë konform nenit 452.4 të LPK-së.

Nga të cekurat më lart e në bazë të neneve 142.5, 423.3 dhe 452.4 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2023:255361, 28.06.2024**

Gjyqtari
Berat Spahiu

Udhëzim mbi mjetin juridik: Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj gjykate.